



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr.45/23

Datë 15.03.2024

FTESË PËR SEANCË

FTOHET i akuzuari **SLLAVISHA FILIQ**, i biri i Vojislav, i lindur me datë 25.07.1963, në Prishtinë, me vendbanim të panjohur jashtë Republikës së Kosovës, të marrë pjesë në seance fillestare të caktuar me datë **15.05.2024, e mërkurë, në ora 09:00**, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, për çështjen penale të proceduar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS. nr.330/2009, të datës 15.09.2023**, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krimet e Luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Konform nenit 303 par 8. të KPPRK-së, gjykata i bërë thirrje të të akuzuarit **Sllavisha Filiq**, të dorëzohet dhe të paraqitet sa më pare pranë kësaj gjykate, që kjo çështje penale të zhvillohet me prezencën e tij në seancën e caktuar me datë dhe në kohë si më lartë.

Konform nenit 303 par 8. të KPPRK-së, gjykata i bërë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit **Sllavisha Filiq**, që t'ia komunikojë atë informacion policisë, me qëllim të sigurimi të prezencës së akuzuarit **Sllavisha Filiq**, në këtë çështje penale.

Bashkangjitur: Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS. nr.330/2009, të datës 15.09.2023**, kundër të akuzuarit **Sllavisha Filiq**, për shkak të veprës penale si më lartë.

Kryetarja e trupit gjyqësor-gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra





GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA

15. 09. 2023

E PRANUAR



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Speciale / Specijalno Tužilaštvo / Special Prosecution

Departamenti për Krime Lufte / Odeljenje za Ratne Zločine / War Crimes
Department



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

PPS.nr.330/2009
Prishtinë

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, neneve 48, 234 par.1 dhe 2, 235 para.1 nën parag 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 dhe 1.10, dhe nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje "KPPK") dhe nenit 5 shkronja (f) të Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (tutje "Ligji për PSRK"), dhe nenit 13 paragrafi 1, ngriti:

AKTAKUZË
në mungesë

Kundër të pandehurit:

SLLAVISHA FILIQ, nga i ati Vojislav, i lindur me 25.07.1963 në Prishtinë, deri në vitin 1999 me vendbanim në Rr. "Jablanicka", nr. 20 Prishtinë, tani me vendbanim të panjohur jashtë Republikës së Kosovës, ish - pjesëtarë i Sigurimit Shtetëror në Prishtinë - Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (MPB), i cili aktualisht është i pa kapshëm për organet e ndjekjes;



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

S e p s e

Ekziston dyshimi i bazuar mirë, se i pandehuri Sllavisha Filiq, në cilësinë e personit zyrtar, si Pjesëtar i Sigurimit Shtetëror të Serbisë, së bashku edhe me dy zyrtarë tjerë të këtij shërbimi, deri më tani te panjohur për organet e ndjekjes, me datë 10/04/1998, derisa viktima Hafir Shala, mjek me profesion, po udhëtonte me veturë private nga Gllogoci për në Prishtinë së bashku edhe me dy persona tjerë, përkatësisht Hetem Sinanin dhe Shaban Hazirajn, me të arritur në udhëkryqin e Sllatinës, afër aeroportit të Prishtinës, të njëjtit janë ndaluar nga pjesëtarë të uniformuar të Policisë Serbe dhe Sigurimit Shtetëror të Serbisë, në mesin e të cilëve ishte edhe i pandehuri Slavisha Filiq, në atë mënyrë që pasi ishin ndaluar, fillimisht ishin legjitimuar nga ana e policisë, pastaj Dr. Hafir Shala ishte marrë nga i pandehuri Sllavisha Filiq dhe dy të dyshuarit tjerë - të tre të veshur me rroba civile, i njëjti ishte futur në veturën "Opel", e tipit "Frontera", me targa të regjistrimit PR-986-16, të cilën e drejtonte i pandehuri Sllavisha Filiq dhe ishte dërguar në ndërtesën e Sigurimit Shtetëror në Prishtinë, ku fillimisht u ishte nënshtruar rrahjeve dhe torturave dhe nga ajo ditë për fatin e tij nuk dihet asgjë, andaj lidhur me këtë;

- Me këtë, në bashkëkryerje, ka kryer veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të RSFJ-së

Andaj,

PROPOZOJ

Që gjykata, në bazë të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale, të caktoj dhe të mbajë seancën e shqyrtimit gjyqësor në mungesë në të cilën do të ftohen:

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;

1. I pandehuri Sllavisha Filiq, me adresë banimi të panjohur;
2. Avokati i të pandehurit i caktuar nga ana e Gjykatës.

Dëshmitarët e prokurorisë:

- Destan Rukuqi
- Selman Kadriu



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

- Isuf Shala
- Shaban Neziri
- Hetem Sinani
- Fadil Syla
- Sedat Shala
- Fisnik Thaqi
- Sedat Shala
- Zahrije Podrimqaku
- Hysni Bequku
- Shaban Shala
- Xhemajl Alushani
- Sheremet Shala
- Isuf Shala dhe
- Shukrije Shala

Gjithashtu, propozoj që gjatë procedurës së shqyrtimit të provave në harmoni me Kapitullin XVII të KPPRK-së, të administrohen këto prova: deklaratat e dëshmitarëve të cekur si më lart, si dhe në cilësinë e provës të administrohet edhe certifikata e vdekjes me numër të referencës 19/2021RV/19001 të datës 05/03/2023 e lëshuar nga organi kompetent për dëshmitarin Fadil Syla.

Në bazë të nenit 449 paragrafi 2 të KPP-së propozoj që ta obligoni të pandehurin, që *ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogaritjes së gjykatës.*

Në fund, propozoj që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

A r s y e t i m i

Me datë 14.06.2019, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Departamenti për Krime të Luftës, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit Sllavisha Filiq, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale Krime Luftë kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së.

Me qëllim të zbardhjes së rastit dhe duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e tij meqë kemi të bëjmë me një rast që ka të bëjë më vepra penale Krime të Luftës ,



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

hetimi i të cilave është shumë i ndërlikuar dhe specifik dhe faktit se rastet e tilla kërkojnë më shumë kohë për veprime hetimore, kjo prokurori në bazë të kërkesës së datës 05.05.2021 kishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special vazhdimin e hetimeve edhe për gjashtë (6) muaj për të pandehurin Sllavisha Filiq.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin e datës 17.05.2021 kishte aprovuar kërkesën e PSRK-së, për vazhdimin e hetimeve ndaj të pandehurit Sllavisha Filiq lidhur me veprën penale Krime Lufte kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së.

Gjatë fazës së hetimit, janë ndërmarr një mori veprimesh hetimore për mbledhjen e provave materiale relevante juridike, janë dëgjuar dëshmitarët si dhe janë siguruar prova materiale bindëse lidhur me kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale dhe shume veprime tjera procedurale.

Në kuadër të veprimeve procedurale, fillimisht kjo prokurori me datën 09.09.2019 ka autorizuar Policinë e Kosovës - Njësinë e Hetimeve të Krimeve të Luftës në Prishtinë, të sigurohen informata lidhur me vendbanimin e të pandehurit të lartcekur, dhe nga të njëjtit ka pranuar raport informues ku hetuesit e NHKL-së kanë shkuar në adresën e vendbanimit të tij për ta kërkuar, mirëpo i njëjti nuk jeton në atë adresë dhe se nuk dihet se a ka adresë vendbanimi në territorin e Republikës së Kosovës, andaj ka qenë e pamundur që të sigurohet prezenca e të pandehurit për të dhënë sqarime lidhur me veprën penale për të cilën dyshohet, por që dyshohet se i njëjti është larguar nga Kosova për në vendbanim të panjohur.

Me datë 28.01.2020, Prokuroria Speciale, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special ka paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhër arrestit kundër të pandehurit të lartcekur.

Me datë 31.01.2020 Gjykata ka aprovuar kërkesën e PSRK-së dhe ka lëshuar Urdhër arrest kundër të pandehurit në fjalë (urdhër arresti nën shenjen PPPS.nr.63/19

Me datë 18.02.2021, PSRK, iu ka drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special - Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, me kërkesë për vazhdimin e urdhër arrestit, dhe me datë 22.02.2021 kjo Gjykatë ka aprovuar kërkesën e prokurorisë duke lëshuar Urdhër arrest kundër të pandehurit në fjalë.

Me datë 19.02.2021, kjo Prokurori iu ka drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me kërkesë për lëshimin e Letër rreshtimit dhe Letër



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

rreshtimit Ndërkombëtar kundër të pandehurit Sllavisha Filiq, ku gjykata me datën 23.02.2021 ka lëshuar Letër rreshtim vendor ndaj te pandehurit në fjalë.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me datën 24.02.2021 ka bërë kërkesë për lëshimin e Letër rreshtimit Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës - Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Në bazë të kërkesës së PSRK-së të datës 20.01.2023, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Speciale, me datën 24.01.2023 ka lëshuar urdhër për shpalljen në kërkim të personit nën hetim përmes mjeteve të informimit publik, përfshirë gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kjo prokurori, pasi ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe pas përfundimit të hetimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konsideron se janë siguruar prova të mjaftueshme materiale nga të cilat pa mëdyshje do të vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale dhe se në veprimet e tij ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e kësaj Aktakuze.

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve;

Dëshmitari Shaban Neziri, në deklaratën e tij të dhënë me datën 14.04.2003, pranë zyrtarë policor të UNMIK-ut, ka deklaruar se; me 10 Prill 1998 rreth orës 08:00, së bashku me Hetem Sinanin dhe Dr. Hafir Shalën kanë qenë duke shkuar rrugës nga Glllogoci për në Prishtinë. Në udhëkryqin e aeroportit të Prishtinës në Sllatinë, policët serb me uniforma i kanë ndaluar, ku së bashku me policët ishin edhe tre persona të armatosur me rroba civile duke qëndruar në udhëkryq afër xhipit të zi, Opel Frontera, me tabela të regjistrimit PR-968-16. Shton se pasi që i kanë ndaluar policia, iu kanë kërkuar lejet e njoftimit dhe i kanë kontrolluar, pastaj dy personat e armatosur në rroba civile e morën Dr. Hafir Shalën dhe futen në xhipin e tyre të lartcekur, derisa tjetri në rroba civile, gjithashtu i armatosur dhe me radio lidhje i ka urdhëruar dëshmitarin dhe Hetem Sinanin të shkojnë me ata me veturën e Shaban Nezirit dhe Hetem Sinanit. Së bashku me ata kanë vozitur në drejtim të Prishtinës, derisa xhipi i zi ku ishte i ulur Dr. Hafir Shala vinte prapa tyre. Shton se kur kanë arritur në Prishtinë, kanë qenë të urdhëruar që ta parkojnë veturën përballë ish SUP-it, ku pastaj policia ia kanë marrë të gjitha dokumentet personale të cilat i ka pasur me vete, pastaj e kanë dërguar në katin e tretë të ish ndërtesës së SUP-it, ku e kanë mbajtur deri rreth orës 14:30 min atë ditë. Posa ka hyrë në korridor të ndërtesës, e ka dëgjuar Dr. Hafir Shalën duke bërë sikur të ishte duke u torturuar, ky u ndalë dhe e ka pyetur njeriun



Numri i lëndës: 2019-0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

i cili kishte ngasur veturën e tyre por i njëjti i ka bërtitur dhe i ka thënë që të shporret nga i vend. Pasi ka dalë nga ndërtesa e ish SUP-it, se bashku me Hetem Sinanin kanë vendosur që të shkojnë në Këshillin për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut në Prishtinë për ta raportuar rastin dhe që t'i informojnë ata për rastin e Dr. Hafir Shalës. Pas disa bisedave me Hetemin kanë vendosur që të shkojnë në shtëpi, dhe prej atëherë Dr. Hafir Shala është i zhdukur dhe nuk kanë më asnjë informacion për atë nëse është apo jo gjallë.

Ndërsa në deklaratën e tij të dhënë me datën 14.11.2019 në Prokurorinë Speciale, i njëjti ndër të tjera ka deklaruar se; Dr. Hafir Shalën e ka njohur pasi që janë prej të njëjtit fshat dhe se janë rritur së bashku. Sipas dëshmitarit Dr. Hafir Shala ka punuar si mjek në shtëpinë e shëndetit në Glllogoc dhe si mjek në Shoqatën humanitare bamirëse "Nënë Tereza", përkatësisht në ambulancat në Krajkovë dhe Bainsë, ku sipas nevojës ka shkuar edhe në të gjitha fshatrat përreth ku ka pasur nevojë. Sipas dëshmitarit, ditën kritike të datës 10.04.1998, atë ditë rreth orës 07:00 të mëngjesit të shtëpia e tij ka shkuar Dr. Hafir Shala i cili i ka thënë se ka për të shkuar në Prishtinë për t'i dërguar raportet mujore të shoqatës dhe të njëjtën kohë ka me marrë barna nga shoqata "Nënë Tereza", dhe për këtë i ka thënë se a mundemi me shku sot me veturën e tij në Prishtinë, meqenëse ky i kishte mundësitë materiale, dhe edhe para këtij rasti i ka shërbyer me automjetin e tij për nevoja të shoqatës. Së bashku kanë shkuar të shtëpia e shëndetit ku punonte Hetemi, aty Dr. Hafiri ka zbritur nga automjeti dhe ka shkuar që ta thërras Hetemin, ndërsa ky e ka pritur në veturë, ku pas pak kanë ardhur të dy se bashku dhe pastaj të tretë janë nisur për në Prishtinë. Pasi kanë arritur në Sllatinë ku ka qenë kryqëzimi i cili të dërgonte te aeroporti, në vendin ku sot është restorant "Aviano", i kanë ndalur policia me uniforma serbe të cilët i kanë legjitimuar dhe i kanë urdhëruar që të dalin jashtë automjetit, e kanë kontrolluar automjetin dhe në ato momente e ka parë se aty ka qenë i parkuar një automjet civil me tabela civile Pr...?, ngjyrë e zezë, ndërsa afër xhipit kanë qenë duke qëndruar tre persona civil prej të cilëve njëri ka pasur në krah një armë automatike kallashnikov. Në atë moment, njëri nga personat civil është afruar afër këtyre dhe e ka marrë Dr. Hafir Shalën së bashku me dokumentacionin - raportet të cilat i kishte për t'i dërguar në shoqatën "Nënë Tereza", në Prishtinë, dhe pastaj e kanë futur në xhipin e lartcekur. Sipas dëshmitarit, i njëjti person i cili e morri doktorin u kthye këta (Shabani dhe Hetemi) dhe i ka urdhëruar që të hyjnë në automjet dhe ai është ulur në ulësen e parë derisa në dorë mbante një radio lidhje me të cilën siç dukej komunikonte me personat të cilët ishin në xhip, ndërsa këta i ka urdhëruar që te nisen për Prishtinë. Pasi kanë arritur në Prishtinë, e kanë parkuar automjetin përballë hyrjes së Sekretariatit të Punëve të Brendshme, te rruga që lidhet me qendër, dhe aty personi që ishte në veturë me ta i ka urdhëruar që të ndalën aty. Pasi e ka parkuar automjetin është munduar që të shikoj se ku është xhipi i zi dhe ka vërejtur se ai nuk u parkua aty por vazhdoi dhe u kthye



Numri i lëndës: 2019:0190727

Data: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

majtas te Banka e Lublanës dhe siç duket hyri mbrapa ndërtesës së Sekretariatit të Punëve të Brendshme (SPB). Sipas dëshmitarit, personi që ishte në automjet me ta, iu ka marrë të gjitha dokumentet, përfshirë edhe dokumentet e automjetit dhe i ka urdhëruar që së bashku me të shkojnë në ndërtesën e SPB-së, ku brenda hyrjes i ka urdhëruar që të presin aty te sigurimi, ndërsa ai vet është larguar. Shton se kanë qëndruar për një kohë të gjatë aty duke pritur dhe në një moment ka vërejtur se në anën e kundërt ekziston edhe një derë e cila ishte e lidhur me parkingun mbrapa SPB-së, dhe meqenëse ishte i interesuar të dijë se çka ndodhi me doktorin, e ka pyetur një polic i cili qëndronte në sigurim afër asaj dere se a mund ta shfrytëzon tualetin, dhe pasi ka marrë aprovimin e tij, ka shkuar dhe duke qenë se dera ishte gjysmë e hapur, ka shikuar në atë drejtim dhe ka vërejtur se xhipi i zi në të cilin e kishin futur Dr. Hafir Shalën ishte i parkuar aty afër derës, me çka ka ardhur në përfundim se edhe Dr. Hafir Shala ishte në atë ndërtesë. Është kthyer përsëri te Hetemi dhe kanë vazhduar të presin aty dhe pasi kanë pritur një kohë, dëshmitarin (Shaban) e kanë thirrur dhe e kanë dërguar në një zyrë në katin e tretë të ndërtesës së SPB-së, ndërsa Hetemi mbeti në korridor duke pritur. Shton se aty e kanë marrë në pyetje deri ka ora 03:00 pas dite, dhe në këtë kohë njëri prej dy personave të cilët e kanë marrë në pyetje i kanë thënë merri dokumentet dhe largohu. Sipas dëshmitarit, ky ka qenë personi i njëjtë i cili ka hyrë në automjetin e tij dhe e ka shoqëruar prej Sllatine deri në Prishtinë. Shton se kur ka dalë në korridor për tu nisur në drejtim të liftit, i kujtohet se derisa ishte në korridor, nga një pjesë e atij katit të njëjtë ku ishte edhe ky, por diku më thellë ka dëgjuar britma të cilat i ka njohur se është zëri i Dr. Hafir Shalës, është ndalur dhe e ka pyetur personin i cili ishte duke e shoqëruar se a mund të di se çka është duke ndodhur me doktorin, ndërsa i njëjti i është drejtuar duke i thënë në gjuhën serbe “Ec në shtëpi dhe shikoj punët tua”, pastaj i njëjti e ka shoqëruar deri jashtë ndërtesës së SPB-së dhe i ka thënë largohu. Në atë moment, dëshmitari është nisur drejt vendit ku e kishte parkuar automjetin dhe kur ka shkuar aty e ka parë se Hetemi ishte aty duke e pritur. Pasi e ka pyetur Hetemin se a dëgjove diçka për doktorin, i njëjti i është përgjigjur se jo nuk di asgjë. Dëshmitari, i ka thënë Hetemit qëndro këtu pari dhe shiko se mos po del Dr. Hafir Shala nga ndërtesa, sepse kishte shpresuar se mos po e lirojnë, ndërsa ky ka shkuar në KMDLNJ për të lajmëruar rastin dhe për të kërkuar ndihmë, sepse ishte e Premte dhe ky brengosej se nëse qëndron në paraburgim gjatë vikendit do të maltretohej edhe më shumë.

Dëshmitari Xhemajl Alushani, në deklaratën e tij të dhënë me datën 03.09.2003 pranë zyrtarëve policor të UNMIK-ut, ka deklaruar se; me 8 janar 1999 ishte duke e ngasur një veturë me shokët e tij Hysni Murseli dhe Agim Syla dhe kur kanë arritur në fshatin Magure në Lipjan, të njëjtit janë ndalur nga njerëz të armatosur nga të cilët janë arrestuar, rrahur dhe janë dërguar në fshatin Golesh, dhe pastaj janë dërguar në Prishtinë. Në Prishtinë, njerëzit që i kanë arrestuar i kanë dërguar në zyrën e MUP-it



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

(shërbimi i Sigurimit të Brendshëm). Shton se nuk i kanë futur në burg por i kanë mbajtur në zyrat e inspektorit Sllavisha Filiq. Sllavisha Filiq dhe disa njerëz të tjerë i kanë marrë në pyetje dhe gjatë tërë kohës e kanë maltretuar, e ku si pasojë e këtyre maltretimeve ka ende shenja prerjesh në këmbë dhe i grushtuar në fytyrë dhe trup. Dëshmitari tutje ka deklaruar se gjatë asaj kohe kur Sllavisha Filiq e ka marrë në pyetje dhe maltretuar, ai dëshironte që ta frikësonte duke i thënë se " mund t'ia bënte edhe këtij atë që i kishte bërë Dr. Hafir Shalës, përndryshe nuk do t'ia vlente që ai ti thoshte vetes se ishte inspektor.

Dëshmitari Isuf Shala, në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 07.02.2008 ka deklaruar se; djali i tij është marrë me datë 10 prill 1998 në orën 10. Shton se ka shkuar në stacionin policor në Drenas/ Glllogoc dhe në Prishtinë me 13 prill të vitit 1998. Në stacion i kanë thënë që Hafiri ndodhet në katin e tretë. Ndërkohë aty ka takuar shefin regjional të Prishtinës. Një polic me mbiemrin Bajraktarovic i cili e njihte Shabanin e bëri një thirrje telefonike në praninë time për të mësuar diçka në lidhje me Hafirin , mirëpo i ka thënë që nuk mundi të siguroj ndonjë informatë. Ka shkuar në Glllogoc/Drenas dhe në Fushë Kosovë mirëpo pa kurrfarë rezultati. Ka dëgjuar thashetheme se dy policët Sllavisha dhe Seferi e kanë marrë Hafirin para se atë ta transferojnë për një javë në Stacionin Policor të Prishtinës. Tre muaj më vonë, kanali televiziv DW ka dhënë lajmin se Hafir Shala është parë i gjallë, mirëpo nuk e di se kur dhe ku është parë i gjallë, por sipas tij njerëzit e fshatit kanë shkuar që t'i përgëzojnë për këtë lajm.

Dëshmitarja Shukrije Shala, në deklaratën e saj të dhënë me datë 13.02.2008 pranë zyrtarëve policor të UNMIK-ut, e njëjta kishte deklaruar se; kishte dëgjuar fjalë se burri i saj kishte kaluar një javë në stacionin policor në Prishtinë, pasi që i njëjti ishte arrestuar nga policia serbe, dhe pas asaj periudhe nuk kanë pasur asnjë informatë tjetër, por që një mik i familjes së tyre me emrin Hysen Bequku nga Drenasi, e ka dërguar një njeri i cili quhet Isa Bunjaku në stacion policor në Prishtinë për të kontrolluar gjendjen e burrit të saj. Isa ishte takuar me Hafirin në stacion të policisë. Sipas informatave që Hysniu ka marrë nga shoku i tij, burri i saj ishte i dobët me shëndet dhe i lodhur. Sipas dëshmitares, Isa ia ka dhënë këtë informatë Hysniut se burri i saj tash ishte në një vend të sigurt dhe se askush nuk do ta keqtrajtoj më atë. Shton se nuk e njeh personalisht Isën dhe as Hysni Bequku por anëtarët e familjes së saj i njohin ata.

Ndërsa në deklaratën e saj të dhënë me datë 21.08.2019 në Prokurorinë Speciale, e njëjta ndër të tjera ka deklaruar se; se lidhur me rastin e burrit të saj, kur është nisur për Prishtinë i njëjti i ka treguar asaj për udhëtimin dhe i ka thënë se nesër do të udhëtoj për Prishtinë së bashku me Shaban Nezirin dhe Hetem Sinanin. Kjo e ka



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

pyetur se a e dinë ata që keni me udhëtuar, i njëjti iu ka përgjigjur duke i thënë se po janë të njoftuar një javë më herët. Dëshmitarja tutje ka shtuar se sipas informatave që ka ajo, siç i kanë treguar, Dr. Hafiri është ndalur rreth orës 80:00 në mëngjes në Sllatinë, ndërsa pasi që e kanë sjellë në Prishtinë, Shabani dhe Hetemi kanë pritur rreth pesë orë para stacionit policor ku aty ka dalë një polic dhe i ka pyetur se për çka po pritni, dhe ata janë përgjigjur se janë duke e pritur doktorin, ndërsa polici iu ka thënë mund të shkoni se doktori nuk lirohet tani. Më pas ata janë kthyer nga Prishtina rreth orës 06:00 në mbrëmje kanë ardhur në shtëpinë e dëshmitares (Shukrijes) dhe i kanë njoftuar se Dr. Hafiri është arrestuar dhe është ndaluar në stacionin policor në Prishtinë. Sipas dëshmitares, meqenëse ishte e premtë, shpresonin që të hënë do të lirohet, mirëpo kjo nuk ndodhi, pastaj pasi që nuk u lirua të hënë atëherë filluan të interesohen dhe e dërguan një mik të tyre Hazir Berisha i cili tanimë është dëshmor, e kanë dërguar tek Hysni Bequku nga Drenasi (tani i ndjeri), i cili ka thënë se ka shkuar ka biseduar me Isa Bunjaku në stacionin policor në Drenas, dhe i njëjti ka shkuar në Prishtinë dhe sipas tij e ka parë Dr. Hafirin dhe ka thënë se është i maltretuar dhe shumë i lodhur por që nga tash nuk kanë me guxuar ta maltretojnë dhe kjo ka ndodhur në javën e parë pas arrestimit. I kujtohet se Shaban Neziri iu ka thënë se ditën e arrestimit derisa ishte në stacion policor e ka dëgjuar britmën e Dr. Hafirit, për të cilën thotë se është e sigurt se ishte britma e tij. Pas kësaj, familja e tyre ka angazhuar avokatët Bajram Kelmendi, Destan Rukiqi dhe Fazli Balaj që të interesohen në lidhje me fatin e bashkëshortit të saj. Fillimisht av. Destan Rukiqi iu ka thënë se Dr. Hafir Shalën e ka marrë Fadil Syleviqi së bashku me një person tjetër me emrin Hamdi por që mbiemri i të cilit nuk i kujtohet, mirëpo fatkeqësisht i njëjti këtë deklaratë më vonë e ka ndryshuar.

Dëshmitarët Sedat Shala dhe Fisnik Thaqi, në deklaratat e tyre të dhëna me datën 09.05.2007 pranë zyrtarëve policor të UNMIK-ut, Njësia për Krime Luftë, ndër të tjera kanë deklaruar se: me datën 10 prill të vitit 1998, Shaban Neziri dhe Hetem Sinani nga Drenasi, kanë shkuar në fshatin Krajkovë, në shtëpinë e Dr. Hafir Shalës dhe e kanë thirrë që t'i shoqërojnë deri në Prishtinë, në Shoqatën "Nënë Tereza", me qëllim që të furnizohen me barna për ambulanten e Drenasit në të cilën punonin në atë kohë. Sipas dëshmitarit, që të tre janë nisur me veturë private të Shaban Nezirit nga fshati Krajkovë për në Prishtinë. Gjatë udhëtimit, Shabani thotë se ka harruar diçka në shtëpi dhe se i duhet të ndalen që ta marr, dhe kur kanë arritur afër shtëpisë, i njëjti është ndal dhe ka hyrë në shtëpinë e tij për pesë minuta. Pas pesë minutave, i njëjti ka dalë nga shtëpia dhe janë nisur për në drejtim të Prishtinës. Gjatë udhëtimit, në udhëkryqin e Sllatinës, veturën të cilën e ngiste Shaban Neziri ndalohet nga policia serbe, me ç'rast Hafirin e kanë marrë policët dhe kanë futur në një xhip të zi dhe e kanë dërguar në stacionin policor në Qendër të Prishtinës, ndërsa Shabanin dhe Hetemin policia serbe i kishin urdhëruar që me veturën e tyre t'i shoqëroj deri në stacionin e atëhershëm



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

policor (92) në Prishtinë. Me të arritur në stacioni policor në Prishtinë, Hafir SHalën e kanë futur brenda nga hyrja e pasme e stacionit po të njëjtit persona, ndërsa Shabanin dhe Hetemin i kanë futur brenda në stacion nga hyrja kryesore. Pas dhjetë minutave të ndalimit Shabani dhe Hetemi ishin liruar nga policia serbe, ndërsa Hafiri ishte ndaluar nga policët serb në stacion. Sipas fjalëve të Hetemit dhe Shabanit, Dr. Hafir Shala është rrahur dhe maltëruar fizikisht. Gjatë arrestimit të Dr. Fadil Shalës, prezent ka qenë edhe polici Fadil Syleviqi, i cili edhe tani është pjesëtar i Shërbimit Policisë së Kosovës. Sipas dëshmitarit, në kohën kur është arrestuar Dr. Hafir Shala, Lufti Ajazi ka qenë Zëvendës Shef i Sigurimit Shtetëror për Pune Sekrete në Prishtinë, ndërsa jetonte në Drenas. Sipas dëshmitarit, të dyshuar lidhur me këtë rast janë Shaban Neziri i cili jeton në Drenas dhe Hetem Sinani nga fshati Nekovc, K-Drenas, i cili tani jeton në Londër dhe të cilët ishin dëshmitar te rastit.

Dëshmitari Hysni Bequku, në deklaratën e tij të dhënë me datën 17.03.2008 pranë zyrtarëve policor të UNMIK, ka deklaruar se; i njëjti ka dëgjuar nëpërmjet thashethemeve rreth Hafir Shalës që është arrestuar në udhëkryqin e Sllatinës në vitin 1998, para lufte. Për arsye të marrëdhënieve të mira me familjen e Hafir Shalës, i ka kërkuar Isa Bunjakut, një shokut të tij i cili në atë kohë punonte inspektor i lartë në Stacionin Policor në Gllogoc, që t'i bënë një shërbim që të pyeste për fatin e Hafir Shalës. Shton se ka dashur të di për fatin e tij për arsye se ka ndier dhimbje për familjen e tij. Sipas dëshmitarit, Isa Bunjaku ka shkuar në Prishtinë, por nuk e di se në cilin vend ka shkuar (Stacion, Qendër paraburgimi apo spital) që ta takoj. Isa Bunjaku i ka thënë se ai (Hafir Shala) ishte në gjendje të mirë shëndetësore por nuk do të lirohet menjëherë. Shton se për Dr. Hafri Shalën nuk ka ë shumë informata. Për Isa Bunjakun, thotë se e ka parë në një gazetë se i njëjti ka vdekur pas lufte dhe se trupi i tij është varrosur nga familjarët e tij.

Dëshmitarja Zahrije Podrimqaku, në deklaratën e saj të dhënë me datën 13.02.2008 pranë zyrtarëve policor të UNMIK-ut, ka deklaruar se; se Hafir Shalën e ka njohur pasi që i njëjti ka punuar si doktor për shoqatën "Nëna Terezë" dhe se kanë pasur një bashkëpunim të mirë me të. Në atë periudhë, në prill të vitit 1998, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut ishte vendosur tek shtëpia e Shaban Neziraj dhe kjo ishte arsyeja pse kjo ishte prezente në atë shtëpi duke punuar për Shoqatën. Atë ditë Shabani ishte me Hafir Shalën dhe ata planifikuan që të shkonin në Prishtinë dhe gjatë rrugës të merrnin edhe Hetem Sinanin. Sipas dëshmitares, përveç Shabanit dhe Hetemit nuk e kanë ditur askush tjetër lidhur me atë udhëtim, dhe se të njëjtit kanë udhëtuar me veturë të Shabanit. Sipas dëshmitares Shabani dhe Hafiri janë kthyer, Hafiri ka qëndruar në veturë ndërsa Shabani ka hyrë në shtëpi, por që nuk e di se kënd e ka thirrur ai sepse kjo ka qëndruar jashtë gjatë asaj thirrje, ndoshta rreth 10 min. Dëshmitarja ka deklaruar se ajo nuk e din se kënd Shabani e ka thirr, por sipas



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

saj kjo thirrje ishte shumë e dyshimtë. Shton se nuk sheh ndonjë arsye që të arrestohet doktori sepse ata nuk kishin barna në veturë. Pas arrestimit, Hetemi i ka treguar dëshmitares ndodhinë që policët e kishin marrë vetëm doktorin në veturën e tyre deri në stacion të policisë, ndërsa në veturën e tyre dy polic iu kishin bashkangjitur Shabanit dhe Hetemit, e ku sipas dëshmitares kjo i duket sikur të jetë një pritë. Shton se e njëjta kurrë nuk i ka besuar Shabanit sepse ai ka mundur t'i njeh policët. Nganjëherë, ai shkonte në stacionin e policisë pasur asnjë arsye të qartë, megjithatë ne ishim të gjithë të frikësuar të dilnim jashtë për shkak të snajperëve dhe policëve. Dëshmitarja tutje ka shtuar se një her kishte pasur një diskutim me Shabanin, pasi që sipas saj Shabani ishte xheloz dhe i hidhëruar në lidhje me Hafirin, duke thënë që ai po sillet sikur shef.

Ndërsa në deklaratën e dhënë në PSRK, me datën 20.08.2019, dëshmitarja Zahrie Podrimqaku - Subashi, ndër të tjera ka deklaruar se; e ka njohur Hafir Shalen, se në atë kohë e njëjta ka punuar për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe ka qenë anëtare e atij Këshilli, ndërsa Dr. Hafiri ka punuar në SH.H. Nëna Terezë dhe ka qenë anëtar i Këshillit të KMDLNJ-së, për fshatin Krajkovë. Gjithashtu ai ka qenë edhe kryetar i Shoqatës për të Burgosurit Politik, K-Gllogoc. Sa i përket rastit të zhdukjes së Dr. Hafir Shalës, dëshmitarja ka deklaruar se atë ditë ka qenë mëngjes, kanë qenë në zyrë të KMLDNJ-së, dhe për herë të fundit është përshëndetur aty dhe është nisur për Prishtinë, ku ka pasur për të marrë barëra për nevoja të Spitalit Ushtarak në fsh. Likovc. Prej zyrës është nisur me Shaban Nezirin nga Fsh. Krajkovë dhe Hetem Sinanin nga Gllogoci të cilët janë nisur me makinën e Shaban Nezirit. Shton se e ka kuptuar që është arrestuar Dr. Hafir shala vetëm pasi është kthyer Shaban Neziri dhe Hetem Siannai të cilët iu kanë treguar për arrestimin e doktorit.

Dëshmitari Hetem Sinani, në deklaratën e tij të dhënë me datën 09.07.2010 para zyrtarëve policor të EULEX, ka deklaruar se; më 10.04.1998 në ora 07:00 të mëngjesit ka shkuar në punë, ndërsa rreth gjysmë ore më vonë ka ardhur edhe Dr. Hafir Shala nga Krajkova, ku ai jetonte. Ai erdhi me Shaban Nezirin me të cilin kishte udhëtuar me veturën e Shabanit. Dr. Hafir Shala, i ka treguar se duhet të shkojnë të dërgojnë raportet e punës dhe kërkesat në Shoqatën Humanitare "Nënë Tereza" në Prishtinë dhe se Shabani do i voziste me veturën e tij deri në Prishtinë. Kur kanë arritur në Sllatinë i ka ndalur policia, ku sipas dëshmitarit një automjet policie ishte parkuar në udhëkryqin për aeroport, pastaj të gjithëve iu kanë thënë të dalin prej automjetit dhe iu kanë kërkuar letërnjoftimet, ndërsa Shabanit ia kanë kërkuar edhe lejen e vozitjes. Policët i kane pyetur të tret se ku po shkon, dhe dëshmitari i ka thënë policit se po shkojnë në Prishtinë, në zyrën qendrore të Shoqatës "Nënë Tereza", dhe gjithashtu edhe ta shihte djalë e tij i cili ishte duke studiuar në universitet. Sipas dëshmitarit, Dr. Hafir Shala i ka thënë policit se e kishte një dosje që përmbante raporte të cilat po i



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

dërgonte në zyrën qendrore të Shoqatës "Nënë Tereza". Policët i kanë marr shënimet e tyre dhe iu kanë kthyer dokumentet, dhe derisa po ndodhte kjo, dëshmitari në ato momente ka vërejtur një automjet Jeep (xhip) të zi, të parkuar pak më larg nga rruga, në anën e majtë të rrugës për ka aeroporti. Sipas dëshmitarit, tre civil qëndronin në vendin afër veturës Jeep (xhip), por jo mu pranë tij. Të tre meshkujt që po qëndronin rreth Jeep- it, erdhën tek automjeti dhe i kanë sulmuar të tre, deri sa këta ishin duke hyrë në automobil. Njëri nga të tre personat i tha Dr. Hafir Shalës të del nga vetura. Njëri nga meshkujt e ka vërejtur dosjen në ulësen e përparme dhe e pyeti se çfarë ishte, ndërsa Dr. Hafir Shala iu përgjigj se përmbante raporte të cilat po i dërgonin në zyrën qendrore të Shoqatës "Nënë Tereza" në Prishtinë. Njëri nga meshkujt e shikoi dosjen dhe e morri dhe pas kësaj tregoi me gisht ka Jeepi dhe e urdhëroi Dr. Hafir Shalën të shkoj në Jeep. Sipas dëshmitarit, njëri nga ata personat i tha të ulet në ulësen e prapme të automobilin të Shabanit. Ai po ashtu, e urdhëroi Shabanin të voziste për në stacionin policor në Prishtinë. Shabani filloi të voziste dhe pas nja 20 min kanë arritur në Stacionin Policor në Prishtinë, dhe pasi kanë arritur në stacion, Shabanit i tha të parkoj automjetin në anën e djathtë të rrugës ku gjendej hyrja kryesore e Sekretariatit të Punëve të Brendshme. Personi që ishte në veturë me Shabanin dhe Hetemin i ka përcjellë deri në dhomën e pritjes te recepcioni. Pas pak, Shabani kishte kërkuar të shkoj në nevojtoare dhe kur është kthyer i ka thënë se është në rregull se e kishte parë Jeepin e parkuar në oborrin e brendshëm të Stacionit Policor. Me këtë dëshmitari ka nënkuptuar se Dr. Hafir Shalën e kishin sjellë në stacion policor. Sipas dëshmitarit, marrja në pyetje ka vazhduar deri në 14:00 pasdite të të njëjtës datë, pastaj ia kanë dhënë letërnjoftimin dhe i kanë thënë të shkoj në shtëpi. Pasi kishte dalë nga objekti dhe ishte ofruar tek vetura e tij, Shabani i ka konfirmuar se i njëjti nuk ishte i lënduar por i ka thënë se e kishte dëgjuar zërin e Dr. Hafir Shalës duke bërtitur nga dhimbjet. Shton se pas kësaj, i ka thënë Shabanit që të shkoj në Këshillin për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe të raportoj se çka kishte ndodhur. Deri sa dëshmitari ishte duke pritur në parking të stacionit policor, njëri nga personat që e kishte marrë Dr. Hafir Shalën në Jeep, kishte dalë nga një lokal në afërsi të vendit ku e patën parkuar automjetin dhe i njëjti i ka bërtitur "Sinan çka po pret", ndërsa ky iu ka sqaruar duke i thënë se po e pret Dr. Hafir Shalën, por i njëjti i ka thënë "humb" dhe se doktori nuk do të kthehet atë natë. Ky është larguar nga aty por që ende ka qëndruar në atë zonë dhe kur është kthyer Shabani me automobil, ky i ka treguar se çka i kishte thënë personi - zyrtari policor, dhe aty menjëherë janë nisur për në Glllogoc, por që prej asaj ditë më kurrë nuk e kap arë Dr. Hafir Shalën.

Dëshmitari Shaban Shala, në deklaratën e ti të dhënë me datën 07.10.2010, pranë zyrtarëve policor të EULEX, ka deklaruar se: e ka njohur Dr. Hafir Shalën sepse kanë punuar së bashku në Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, prej vitit 1991. Me datën 10.04.1998 në mbrëmje ka dëgjuar se Dr. Hafir Shala



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

është kidnapuar në afërsi të udhëkryqit të aeroportit në mes orës 8:00 dhe 09:00 të mëngjesit nga agjentët e shërbimit të regjimit të Millosheviqit. Shton se këtë e ka dëgjuar nga disa shokë, por nuk e di se nga kush. Në mbrëmje është konfirmuar edhe nga Këshilli për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut me anë të telefonit. Më vonë e ka kuptuar se gjatë marrjes së Dr. Hafir Shalës është keqtrajtuar dhe rrahur, e ku si pasojë e kësaj edhe ka vdekur. Sipas dëshmitarit, gjatë kidnapimit të Dr. Hafir Shalës prezent ka qenë edhe Shaban Neziri. Shton se Shaban Nezirin e ka takuar pas 5-6 muajve në shtëpinë e tij, ku ka shkuar një natë tek Shabani rreth orës 23:15 min, dhe e ka pyetur për doktorin. Shabani i është përgjigjur se është marrë nga agjentët e shërbimit ku edhe është rrahur në stacionin policor Nr.1 në Prishtinë. Dëshmitari ka deklaruar se Fadil Syleviqin e ka njohur gjatë procesit gjyqësor kundër Nait Hasanit në vitin 1997. Sa i kujtohet në fund të vitit 1998 gjatë një pike të kontrollit në fshatin Tërstenik, është ndalur një veturë ku brenda ishte Fadil Syleviqi, dhe kanë dyshuar se ky njeri është i dyshimtë sepse ka punuar në sigurimin e shtetit. Pasi dëshmitari ka shkuar në fshatin Terdevc rreth orës 23:00 dhe e ka pyetur dikë nga ushtarët e UÇK-së, se çfarë ka ndodhur, i janë përgjigjur se është një njeri i dyshimtë. Me rastin e hyrjes në dhomën ku ishte Fadil Syleviqi dhe kur e ka parë Fadili dëshmitarin, duke e ditur se dëshmitari e njihnte personalisht Fadilin dhe se e din historinë e tij, është drejtuar nga ai duke ia zgjatur dorën dhe i ka thënë se vendi jot ehtë në qosh të dhomës. Dëshmitari tutje shton se e ka pyetur Fadil Syleviqin se kush e ka kidnapuar Dr. Hafir Shalën, por i njëjti fillimisht ka hezituuar t'i përgjigjet, por pasi që dëshmitari ke ka vënë dorën në revole të cilën e kishte në brez dhe i ka thënë se për herë të parë dhe të fundit do ta marr një vendim nëse nuk përgjigjesh, atëherë Fadil Syleviqi i është përgjigjur duke i thënë se Dr. Hafir Shala është marrë në afërsi të Sllatinës dhe është dërguar në organet e sigurimit, se i njëjti ka qenë dy her prezent gjatë marrjes së tij në pyetje, se të njëjtin e kanë rrahur dhe keqtrajtuar, duke i cekur dy emra të personave që e kane rrahur doktorin, por që dëshmitarit nuk i kujtohen emrat e atyre dy personave. Në fund e ka pyetur se a është gjallë Doktorin apo e kanë mbytur, i njëjti i është përgjigjur se nuk është gjallë dhe se ka mbytur dikush tjetër.

Dëshmitari Destan Rukiqi, në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 18.06.2020 ka deklaruar se i njëjti ka qenë i angazhuar me autorizim nga familjarët e të zhdukurit Hafir Shalës që të kontaktoj me të pasi që i njëjti me datën 10 prill 1998 ishte marre nga policia serbe. Fillimisht kishte shkuar në polici dhe ka pyetur për të dhe se policia nuk i kishte dhënë asnjë informatë, thjeshtë kishin deklaruar se ai njeri nuk ndodhet në lokalet e policisë, në stacionin policor nr.1 në qendër. Pastaj ka kontaktuar me dëshmitarët Hetem Sinani dhe Shaban Neziraj nga Glllogoci që kanë qenë prezent, përkatësisht kanë udhëtuar se bashku me doktorin në të njëjtën makinë, dhe të njëjtit në fshatin Sllatinë i kishte ndalur policia me ç' rast Dr. Hafir Shalën e kanë marrë dhe e kanë futur në një xhip të zi dhe e kanë sjellë në Prishtinë, në lokalet e stacionit policor



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

në Qendër. Dëshmitari tutje ka vazhduar dëshminë e tij duke deklaruar se policia serbe dëshmitarët Hetem Sianni dhe Shaban Neziraj i kanë urdhëruar që me makinën e tyre ta përcjellin xhipin e zi dhe të njëjtit janë paraqitur në stacionin e policisë në qendër. Siç i kanë thënë këta dy dëshmitar në momentin kur kanë hyrë brenda, e kanë dëgjuar zërin, klithmat e doktorit i cili sipas tyre torturohej në lokalet e stacionit policor përkatësisht të Sigurimit të Punëve të Brendshme. Pasi këta dy dëshmitar janë marr në pyetje nga policia, të njëjtit i kanë liruar por që nuk janë takuar më me dr. Hafir Shalën dhe sipas tyre i njëjti më nuk ka dal nga stacioni i policisë. Duke u mbështetur nga këto të dhëna që dëshmitari i ka marr nga dy dëshmitarët okular, dhe pasi që dëshmitari nuk ka arritur të marrë asnjë informatë lidhur me Dr. Hafir Shala, i njëjti në cilësinë e mbrojtësit i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë dhe të gjitha niveleve tjera me kërkesë që të ndërmarrin masat konkrete për të zbuluar se ku gjendet Dr. Hafir Shala të cilin e kishin marrë persona zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë. Dëshmitari ka deklaruar se lidhur me këtë, pasi ka njoftuar edhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut - KMDLNJ-në dhe organizatat tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe mediat dhe pasi ky rast ishte bërë publik përmes tij, sa i kujtohet, ditën e nesërme në zyrën e tij kanë shkuar në cilësinë e hetuesve të policisë Fadil Syleviq, dhe sa i kujtohet një hetues tjetër me mbiemrin Pashiq dhe e kanë pyetur se nga i ka marr informatat të cilat ky i ka publikuar. Shton se informatat rreth kidnapimit të Dr. Hafir Shalës i ka marr nga bashkudhëtarët e tij Shaban Neziraj dhe Hetem Sinani të cilët ditën kritike kanë udhëtuar me të njëjtën makinë nga Glogoci për në Prishtinë. Po ashtu, dëshmitari ka deklaruar se këta zyrtar kanë kërkuar nga ky që t'ua mundësoj kontaktin me dy dëshmitarët e lartë cekur, ku i njëjti pasi ka kontaktuar me dy dëshmitarët Shaban Neziraj dhe Hetem Sianni e ka mundësuar takimin në zyrën e tij të avokatisë, të cilën në atë kohë e kishte në lagjen të Qafa. Shton se në zyrën e tij të avokatisë, në ditën e caktuar, data nuk i kujtohet, kanë ardhur në cilësinë e hetuesve Fadil Syleviq dhe personi Peshiq dhe dëshmitarët Shaban Neziraj dhe Hetem Sianani. Hetuesit kanë biseduar me dëshmitarët në prezencën e tij të cilët në detaje kanë treguar për vendin, kohën dhe mënyrën e kidnapimit të Dr. Hafir Shalës. Fadil Syleviq dhe personi tjetër Peshiq, i kanë thënë se ata do ta hetojnë këtë rast dhe do të shohin se çfarë ka ndodhur, sepse ata ende nuk kanë kurrfarë informata lidhur me këtë rast.

Dëshmitari Selman Kadriu, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datën 13.01.2020, ka deklaruar se; në vitin 1993 është arrestuar nga regjimi shtetëror serb i atëhershëm, duke kaluar një fazë të tmerrshme të hetuesisë, duke e mbajtur për 6 muaj gjatë hetimeve, me ç' rast për çdo ditë është marrë në pyetje dhe është tërhequr në zyrat e sigurimit shtetëror në katin e katër. Sipas dëshmitarit, gjatë kësaj periudhe në hetuesi kanë qenë disa grupe tjera shqiptare ndaj të cilëve janë aplikuar këto procedura si p.sh, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, "Grupi 19",



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

ku ka qenë Shemsi Veseli etj. Shton se pas përfundimit të kësaj faze i njëjti është dënua me 5 vite burg të cilin e ka vuajtur në Burgun e Dubravës dhe se aty është njohur me të gjithë të burgosurit shqiptar. Me rastin e arrestimit të parë në vitin 1993 të njëjtit nga Sigurimi Shtetëror i janë konfiskuar automjetet Audi 100 turbo 4, Mercedes 200 dizell, BMË (bertone), të cilat ishin te blera në Zvicër në mënyrë të rregullt. Shton se automjeti "BMË bertone" ka qenë automjeti i vetëm i tillë në Kosovë, që do të thotë se është vërejtur çdo lëvizje e tij në qytet, dhe si i tillë të njëjtën e ka takuar me dhjetëra herë duke lëvizur nëpër qytet- Prishtinë, madje në disa raste e ka përcjellë për ta vërtetuar se kush po e drejton atë. Madje në një rast i ka dalë përpara me automjetin e tije dhe e ka ndalur, me c' rast e ka parë se të njëjtin ka qenë duke e vozitur personi me emrin Sllavisha Filiq i cili ka qenë oficer i Sigurimit Shtetëror të Serbisë, e cilin thotë se e njihte sepse i njëjti prej kohës së arrestimit të tij të parë, e edhe gjatë tërë fazës të cilën e ka përshkruar e ka marrë në pyetje dhe e ka torturuar, madje duke përdorur edhe elektro shokun, shenjat dhe pasojat e të cilave i vuan edhe tani, në atë rast dëshmitari e ka pyetur Sllavishen se me çfarë të drejte ti e shfrytëzon makinën time, dhe ai ka thënë se "edhe një her më del përpara apo të shoh në afërsi time do të ekzekutoj" dhe i njëjti duke ia thënë këto fjalë e ka nxjerrë revolen dhe e mbajtkë në dorë. Për Sllavisha Filic, dëshmitari ka thënë se ky person gjatë tërë kohës sa ka qene nën hetime ka zhvilluar tortura ndaj tij, dhe se i njëjti është marrë edhe me të gjithë të burgosurit tjerë shqiptar. Sipas dëshmitarit, Sllavisha Filiq ka qenë i gjatë 1.90 cm, ka qenë hendbollist i Universitetit të Prishtinës, dhe se vëllai i tij në atë kohë ka punuar në MPB në Medvegjë, po ashtu sa është në dijeni dëshmitari gjatë kohës së luftës së UQPMB-së, Sllavisha ka Filiq ka operuar në Bujanoc. Shton se viti i fundit kur e ka parë Sllavisha Filiq, ka qenë gjatë vitit 1998, gjatë kohës sa dëshmitari ka qenë i arrestuar dhe Sllavisha në atë kohë e ka tërhequr dhe e ka marr në zyrën e tij ku e ka rrahur dhe maltretuar dhe gjithashtu për 13 dite rresht e ka mbajtur të lidhur për muri për qelinë nr.1 të burgut në Prishtinë. Lidhur me zhdukjen e Dr. Hafir Shales ka deklaruar se për her të parë ka dëgjuar në kohën kur është marre në pyetje nga UNMIK-u, me këtë rast është pyetur lidhur me automjetin "BMË Daihatsu", të cilin e ka shpjeguar më lartë, dhe i janë prezantuar disa fotografi të atij automjeti, ku i njëjti menjëherë ka arritur ta identifikoj automjetin e tij. Po ashtu, dëshmitari ka deklaruar se i njëjti ka dëgjuar se me këtë automjet është rrëmbyer Dr. Hafir Shala dhe me këtë rast ky ka dëshmuar dhe sqaruar se ky automjet prej kohës kur i është marrë tërë kohën është shfrytëzuar nga Sllavisha Filiq.

Ndërsa në deklaratën e tij të dhënë me datën 30.07.2003 para zyrtarëve policor të UNMIK, ka deklaruar se; në mars të vitit 1994, shtëpia e tij ishte rrethuar nga policët dhe se ky ishte arrestuar, rrahur dhe plaçkitur. Gjatë asaj kohe i njëjti ishte i njohur si një ndër më të pasurit në këtë vend, duke shtuar se policët i kanë marr me vete gati të gjitha nga shtëpia e tij, duke përfshirë tri automjetet e tij, Audi 100 turbo ngjyrë e zezë,



Numri i lëndës: 2019-0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

Mercedes 200 me ngjyrë të bardhë dhe Xhipin e zi Bertone BMË. Shton se i ka njohur këta të tre polic të cilët ishin në shtëpinë e tij dhe të cilët e kanë arrestuar dhe sipas tij këta polic ishin Sllavisha Filic, Xhafer Beiqi dhe një tjetër të cilin e thërrisnin "Major". Kur i njëjti është liruar në gusht të vitit 1996, ka filluar t'i kërkoj veturat e tijtë cilat policia ia kishte marrë nga ky dhe kishte kuptuar se xhipin e tij të zi e kishte polici serb Sllavisha Filiq. Dëshmitari deklaroi se e ka parë atë duke e vozitur xhipin e tij, dhe kur ky e ka vizituar në zyrën e tij dhe e ka lutur që t'ia kthej, i njëjti ishte shumë arrogant dhe kur ky i ka kërkuar veturën e tij, i njëjti dëshmitarin e ka rrahur në zyrën e tij. Sipas dëshmitarit, Sllavisha Filiqi i ishte kërcënuar që ky do ta harroj këtë të rrahur se çka do t'i bënte ai në të ardhmen nëse vazhdon ta kërkoj veturën e tij. Dëshmitari shton se ky përsëri e ka parë Sllavishen duke e ngarë xhipin e zi, ky e ka vërejt se ai përdorte tabelat e ndryshme të regjistrimit në xhip, por shton se ky përsëri se përsëri e ka identifikuar veturën e tij sepse në atë kohë ishte vetëm një kësi lloji në Prishtinë, pas kësaj dëshmitari ka kërkuar ndihmë nga avokati serb Zhivojin Jokanovic që ta merr veturën por asgjë nuk kishte ndodhur. Shton se Sllavisha Filic dhe Xhafer Beiqin i ka njohur sepse kur ky ishte në burg për më shumë se dy vite, ky gjithmonë i ka para ata duke sjellë të burgosur politik aty brenda, ku aty ishte edhe një i burgosur politik në dhomë me të me emrin Bilall Sula, dhe ai i ka thënë se e njohte Sllavisha Filiq shumë mirë sepse kishin jetuar në të njëjtin ven më parë.

Dëshmitari Fadil Sylal¹, në deklaratat e tij të dhëna në polici me datë 18.02.2010 dhe në Prokurorinë Speciale me datën 08.01.2020, ndër të tjera ka deklaruar se; lidhur me këtë rast nuk i kujtohet saktësisht data dhe muaji, por mban mend se atë dhe një koleg të tij me emrin Pesic Milic, i ka ngarkuar ish shefi i Dikasterit me një shkresë në të cilën përshkruhej zhdukja e Dr. Hafir Shalës, të cilin e kishte adresuar avokati Destan Rukiqi drejtë Ministrisë së Drejtësisë në Beograd. Kjo shkresë kishte ardhur nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë, në dikasterin tonë me kërkesë që të hetohen dhe zbulohen pretendimet e avokatit Destan Rukuqu se Dr. Hafir Shala është kidnapuar dhe zhdukur nga policia. Shton se këtë letër e kanë marrë pasi që të njëjtit shin kujdestar atë ditë, sipas orarit të kujdestarisë javore dhe posa e morën letrën ky dhe kolegu i tij kanë shkuar në zyrën e avokatit Destan Rukiqi, që atëherë gjendej te kompleksi "Qafa", me qëllim që të marrin informacione shtesë në lidhje me pretendimet e avokatit se policia e kishte kidnapuar Dr. Hafir Shalën, dhe se tani më nuk dihej se ku është. Në kontaktin e parë me av. Destan Rukiqi, i njëjti i ka njoftuar hetuesit se së bashku me Dr. Hafir Shalën kanë qenë edhe dy qytetar tjerë të cilët mund të mirën në cilësinë e dëshmitarëve me qëllim që të shpjegojnë mënyrën e kidnapimit,

¹ Dëshmitari ka ndërruar jetë me datë 15/01/2021, e cila dëshmohej edhe me certifikatën e vdekjes me nr. të referencës 19/2021RV/19001 të datës 05/03/2023 e lëshuar nga organi kompetent. Andaj propozojmë që e njëjta deklaratë të lexohet në procedurë të provave dhe të merret si provë e drejtëpërdrejtë, konform nenit.335, par.1, nën par.1.1 të KPPRK-së.



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

vendin kidnapimit dhe personat të cilët e kanë kidnapuar. Pasi kanë kontaktuar me këta dy qytetar në zyrën e avokatit Destan Rukiqi, të njëjti iu kanë shpjeguar se disa inspektor civil së bashku me një patrullë të policisë i kishin ndaluar në udhëkryqin e rrugëve Sllatinë - Prishtinë - Aeroport, dhe se aty i kishin arrestuar që të tre, dhe më pas sjellë në ndërtesën e Sigurimit Shtetëror, e cila gjendej në ish - rrugën e Kragujevcit, ndërtesa ngjitur me ish Burgun e Prishtinës. Sipas deklaratave të dëshmitarëve, ata ishin sjellë nga parkingu i ndërtesës që gjendej mbrapa ndërtesës së Sigurimit Shtetëror dhe sapo kishin hyrë brenda i kishin ndarë nëpër zyre të caktuara ku dëshmitarët kishin dëgjuar zëra dhe rënkime nga rrahjet dhe maltretimet që ia bënin në një nga zyrat Dr. Hafir Shalës. Më pas, sipas deklaratave të dëshmitarëve, dëshmitarin Shabanin dhe personin tjetër me emrin Hetem Sinani, i kishin liruar nga dera kryesore e rrugës, dhe nga ai moment nuk dihej me se çka ka ndodhur me Dr. Hafir Shalën. Dëshmitarët iu kanë dhënë edhe përshkrimin e automjetit të cilin e kishin shfrytëzuar ish oficerët e sigurimit shtetëror për rrëmbimin e Dr. Hafir Shalës. Këta pa dyshim kanë konstatuar aty për aty se pjesëtarë të sigurimit Shtetëror e kishin rrëmbyer - kidnapuar Dr. Hafir Shalën dhe ketë e kanë bazuar mbi bazën e ndërtesës dhe vendit se ku ishte sjellë. Gjithashtu, këta në bazë të përshkrimit të dëshmitarëve, pa dyshim kanë konstatuar dhe vërtetuar se njeri nga kidnapuesit ishte Slavisha Filic, inspektori i Sigurimit Shtetëror, këtë e kanë vërtetuar nga përshkrimi i personit, veshjes së personit dhe përshkrimi i veturës e cila është shfrytëzuar për kidnapim. Madje Dëshmitari Shaban Neziri, në mënyrë decidive dhe me bindje të plotë u deklarua se në mesin e 100 personave ai është në gjendje ta rinjoh inspektorin Sllavisha Filic. Dëshmitari Fadil Sylja, tutje ka deklaruar se ai personalisht nuk e ka njohur dhe nuk ka pasur kontakte me Sllavisha Filic, por që të njëjtin e ka njohur vetëm si figurë, dhe e ka ditur që i njëjti ka punuar në Sigurimin Shtetëror.

Përmbledhje e raporteve materiale;

Në kuadër të veprimeve procedurale që kjo prokurori ka ndërmarrë lidhur me mbledhjen e provave dhe informatave për sqarimin me te qarte të kësaj çështje penale, janë edhe raportet si;

- Urdhëresa për shpalljen në kërkim të të pandehurit me numër të rastit PPPS. Nr. 63/19, i datës 24.01.2023;
- Kërkesa për lëshimin e urdhrit për shpalljen e personit në kërkim me numër të rastit PPS. Nr. 330/09, i datës 20.01.2023 për të pandehurin Sllavisha Filic;
- Raporti informues lidhur me sigurimin e informatave lidhur me adresën e vendbanimit të të pandehurit Sllavisha Filic me numër të rastit 06/-01/KL-25/2021, i datës 10.02.2021;



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

- Vazhdim i urdhër arrestit i datës 24.02.2021 i lëshuar nga gjykata themelore në Prishtinë kundër të pandehurit Sllavisha Filic;
- Kërkesa e Prokurorisë Speciale për vazhdimin e urdhër arrestit i datës 18.02.2021;
- Urdhër arresti me numër të Rastit PPPS.63/19 i datës 03.02.2023, i lëshuar nga gjykata themelore në Prishtinë - Departamenti Special;
- Kërkesa e gjykatës themelore në Prishtinë - Departamenti speciale për lëshimin e Letër rreshtimit Ndërkombëtar, i datës 26.02.2021.
- Letër rreshtimi vendor i datës 26.02.2021, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, kundër të pandehurit Sllavisha Filic.
- Kërkesa e Prokurorisë Speciale për lëshimin e letër rreshtimit vendor dhe ndërkombëtar të datës 19.02.2021
- Kërkesa e Prokurorisë Speciale për lëshimin e urdhër arrestit të datës 28.01.2023;

DEKLARATAT E TË PANDEHURIT;

I pandehuri përkundër që është ftuar disa herë nga ana e policisë dhe prokurorisë për tu deklaruar lidhur me dyshimet që i vihen në barrë lidhur me kryerjen e veprës penale sipas kësaj aktakuze, i njëjti deri në këtë fazë të procedurës është bërë i pa kapshëm për organet e ndjekjes penale.

Ligji i aplikueshëm për rastin konkret;

Neni 3 i KPRK-së, i referohet situatës kur zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin dhe ka përcaktuar se (1) ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, (2) në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

Për të përcaktuar se cili është ligji më i favorshëm për të pandehurin në rastin konkret, prokurori i shtetit ka marr për bazë jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Kosovës. Me aktgjykimin Pml.nr.138/2021 të datës 05.05.2021, në rastin e të dënuarit Darko Tasiç, Gjykata Supreme, ka konstatuar se, citoj: "... për të gjitha veprat penale të krimeve



Numri i lëndës: 2019:0190727

Datë: 15.09.2023

Numri i dokumentit: 02683106

të luftës dhe për veprat e tjera të cilat janë kryer deri me datë 27 tetor 2020, e për të cilat është zbatueshëm Ligji Penal i Jugosllavisë,...

Andaj, prokurori i shtetit ka vendosur që të pandehurin ta akuzoj për veprën penale të përcaktuar në nenin 142 të LP i RSFJ, duke e zbatuar nenin 3 par.2 të KPRK-së. Po ashtu, kjo veprë penale vazhdon të jetë e ndëshkueshme sipas neneve 153-156 të KPRK-së.

Gjendja juridike;

Neni 142 i LP i RSFJ, ka përcaktuar në mori elementesh të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale të krime luftës kundër popullsisë civile.

Në kontekstin e subjektit që mund të jetë kryes i kësaj vepre penale, dispozita e këtij neni fillon me formulimin "*Kush duke shkelur....*". Kjo nënkupton se kryes i kësaj vepre penale mund të jetë cildo person fizik. Prokurori i shtetit vlerëson se, duke marrë parasysh natyrën e veprës penale të krimeve të luftës, ligdhënësi ka përcaktuar se nuk është patjetër që kryesi të jetë pjesëtarë i ndonjë formacioni ushtarak, paraushtarak apo ndonjë formacioni tjetër. Këtë qëndrim juridik e ka dhënë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në rastin me numër *Pml.nr.351/219 të datës 26.12.2019*.

Tutje, si element i veprës penale nga neni 142, parashihet edhe shkelja e rregullave të së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur apo okupacionit. Në rastin konkret, praktika gjyqësore e Gjykatës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi dhe e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka vërtetuar faktin se në periudhën kohore 1998 deri në Mars 1999, ka pasur konflikt të armatosur kurse nga 24 mars 1999 deri me 11 qershor 1999 ka pasur luftë në kuptimin juridik të kësaj shprehje.

Prandaj, gjatë tërë periudhës kohore relevante për këtë aktakuzë, në zbatim ishin rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përcaktuar në katër (4) Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe protokollet e saj. Protokollin -II- i vitit 1977, përcakton rregullat e të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e civilëve në konflikte të armatosura *Jo-ndërkombëtare* ashtu që në nenin 4 paragrafi 2, *shprehimisht ndalon* - shkronja (c) - marrjen e pengjeve dhe shkronja (e) - cenimin e dinjitetit të individit, veçanërisht trajtimet poshtëruese e degraduese, etj. Lidhur me definicionin e termit "marrje peng", i cili është objekt i kësaj aktakuze, jurisprudenca ndërkombëtare dhe vendore nuk ofron një definicion specifik. Megjithatë, ekziston një opinion i përgjithshëm se marrja peng nënkupton personat të cilët janë në duart e palës në konflikt ose agjentit të tyre, me ose pa vullnetin e tyre, liria e të cilëve, integriteti trupor i tyre dhe jeta, varen nga ekzekutimi i urdhrave që u janë dhënë.



Numri i lëndës: 2019-0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

Këto rregulla, të cilat ishin të ratifikuara nga ish- Jugosllavia, kanë përcaktuar masa mbrojtës për popullsinë civile në kohë konflikti dhe lufte, shkelja e të cilave përbën element të ndonjëres nga veprat penale kundër njerëzimit dhe të së drejtës ndërkombëtare të përcaktuara në Kapitullin XVI, nenet 141 -156, të LP të RSFJ-së.

Dispozita e nenit 142 të KP të RSFJ në pjesën relevante përcakton me sa vijon:

kushdo që duke shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, urdhëron që popullata civile të jenë subjekt i [...] marrja peng e njerëzve, [...] apo që kryen një nga aktet e përmendura [...].

Prokurori i shtetit vlerëson se ky nen ka paraparë dy (2) mënyra të kryerjes. Kushti i parë i referohet rasteve kur dikush urdhëron kryerjen e një vepre dhe kushti i dytë është kur dikush e kryen atë. Në rastin konkret, i pandehuri e ka kryer njërin nga veprat penale të listuara në nenin 142. Hetimi vërtetoi se i pandehuri e ka kryer veprën penale të "marrjes së njerëzve peng", që është njëra nga veprat e listuar në nenin 142 të cekur më lartë. Provat materiale dëshmojnë se i pandehuri e ka rrëmbyer viktimën Hafir Shala, i cili së bashku edhe me dy persona tjerë ishte duke shkuar me veturë për në Prishtinë, nën kërcënimin e armës, maltretimit fizik dhe psikik.

Tutje, në lidhje me figurën e veprës penale nga neni 142 të LP- RSFJ-së, jurisprudenca vendore dhe ndërkombëtare ka zhvilluar një interpretim të gjerë dhe të detajuar. Në këtë aspekt Gjykata e Apelit me aktgjykimin numër PAKR.nr. 1121/12 të datë 25 shtator 2018, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr.125/2014 të datës 8 korrik 2014, ka përcaktuar standardin ligjor që e përbën figurën e veprës penale nga nenin 142 të LP të RSFJ-së. Gjykata thekson se, citoj: "

Me qëllim të përcaktimit nëse veprimet e të akuzuarit përbëjnë një krim lufte, duhet të adresohen këto elemente:

- a) a ka qenë duke u zhvilluar ndonjë konflikt i armatosur në Kosovë më ose rreth datës
- b) cilat kanë qenë normat e zbatueshme të cilat e kanë sunduar konfliktin e atëhershëm të vazhdueshëm të armatosur,
- c) a ka qenë konflikti i armatosur i natyrës ndërkombëtare apo jo ndërkombëtare,
- d) a ishin viktimat persona të mbrojtur nën ligjin ndërkombëtar, -
- e) a ka pasur lidhshmëri në mes të konfliktit të armatosur dhe veprës penale



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

Prokurori i shtetit konsideron se në rastin konkret, të gjitha provat materiale dëshmojnë se elementet e figurës së veprës penale të cekur më lartë, janë përmbushur sepse:

E para, lidhur me faktin nëse kishte një konflikt të armatosur në periudhën kohore objekt i kësaj aktakuze, prokurori i shtetit vlerëson se nuk ka dyshim se në atë kohë ka ekzistuar një konflikt i armatosur në Kosovë në periudhën kohore 1998 – qershor 1999. Kjo është vërtetuar nga jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare Kundër Jugosllavisë në rastin *Milutinović etj.* Prandaj, nuk është kontestues fakti se kishte konflikt të armatosur në atë periudhë kohore objekt i këtij shqyrtimi penal.

E dyta, lidhur me normat e zbatueshme, vlerësojmë se tashmë jurisprudenca e GJNKJ dhe e GJS të Kosovës e kanë vërtetuar faktin se në raste të tilla, ishte i zbatueshëm Ligji Penal i RSFJ-së dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare. Me aktgjykimin numër Pml.nr.138/2021 të datës 05.05.2021, Gjykata Supreme, ka konstatuar se ligj i zbatueshëm është Ligji Penal i Jugosllavisë.

E treta, lidhur me natyrën e konfliktit, prokurori i shtetit vlerëson se jurisprudenca e Gjykatës ndërkombëtare kundër Jugosllavisë në rastin *Milutinovic etj.*, *Sreten Lukic etj* dhe Jurisprudenca Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin *Selim Krasniqi etj*, *Latif Gashi etj*, tashmë e kanë vërtetuar faktin se në territorin e Kosovës, duke filluar nga/ose rreth muajit Shkurt të Vitit 1998 deri me datën 24 mars 1999, ka pasur konflikt të armatosur të karakterit *jo-ndërkombëtarë*, në mes të pjesëtareve të UÇK-së dhe forcave ushtarake dhe policore të RSFJ-së dhe Serbisë, kurse nga data 24 mars 1999 deri me 20 qershor 1999 ka pasur konflikt të armatosur të karakterit *ndërkombëtar* për shkak të përfshirjes së forcave të NATO-s në konflikt.

Prokurori i shtetit vlerëson se standardi ligjor i cekur më lartë, i vendosur nga jurisprudenca e Gjykatave të Kosovës, përkitazi me faktin nëse vepra penale përbën krim lufte, në rastin konkret plotësohet. Është fakt i pa kontestueshëm se i pandehuri ishte i vetëdijshëm se veprimet e tij ishin pjesë dhe kontribuuan në kryerjen e krimeve kundër popullsisë civile nga forcat Serbe kundër popullsisë jo-serbe në Prishtinë dhe fshatrat për rreth. Se kishte një dhunë sistematike dhe të shpërndarë të forcave serbe dëshmon aktgjykimi Gjykatës Ndërkombëtare Kundër Jugosllavisë në rastin *Milutinović etj.*

Në bazë të asaj që u tha më lart, prokurori i shtetit vlerëson se të gjitha elementet subjektive të kryesit në raport me veprën penale të kryer, janë vërtetuar, duke përfshirë dashjen, dijeninë dhe qëllimin e tij në raport me veprën e kryer.



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

Gjendja faktike;

Prokurori i shtetit ka shqyrtuar të gjitha provat materiale relevante juridike, të siguruara gjatë hetimit dhe ka ardhur në përfundimin se vepra penale objekt i kësaj aktakuze është kryer dhe se i pandehuri subjekt i kësaj aktakuze, është kryes i saj. Kjo dëshkohet nga deklaratat e dëshmitarëve, nga raportet policore dhe nga procesverbalet e identifikimit të të pandehurit.

Andaj, prokurori i shtetit vlerëson se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të kësaj aktakuze është vërtetuar, se identifikimi i të pandehurit është i saktë dhe nuk ka asnjë dyshim lidhur me identitetin e tij dhe se me provat e siguruara gjatë hetimit dhe të përshkruara në këtë aktakuzë vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën po akuzohet.

ARSYET E PROPOZIMIT PËR MASË SIGURIE;

Prokurori i shtetit propozon që sapo i akuzuari të arrestohet, ndaj të njëjtit të caktohet **paraburgimi**, për faktin se i njëjti përkundër që është ftuar disa herë për tu paraqitur për tu dëgjuar para prokurorit të çështjes, i njëjti ende vazhdon të mos i përgjigjet thirrjeve të policisë dhe prokurorisë për intervistim.

Lidhur me vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, prokuroria gjatë shqyrtimit dhe analizimit gjeti se për sa i përket rrethanave lehtësuese, nuk ka arritur të vërtetoj asnjë rrethanë të tillë, pasi që i pandehuri, deri në këtë moment, është i paarritshëm për organet e ndjekjes, e që në të kundërtën, po të ishte prezent dhe pas dëgjimit të tij, do të i konsiderohej si e favorshme për të pandehurin.

Ndërsa si rrethanë rënduese prokuroria konsideron se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri Slavisa Filic, është kryer me dashje direkte, shkalla e përgjegjësisë penale në këtë rast është e lartë, ka ekzistuar motivi dhe intensiteti i lartë për kryerjen kësaj vepre penale, ashtu që ka përdorur dhunën, kanosjen dhe rrëmbimin, si dhe rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër penale, e që në mënyrë më të hollësishme përshkruhet si në vijim:

- a. vepër e rrezikshmërisë së lartë - krime lufte kundër popullatës civile, vepër kjo e sanksionuar edhe me ligje dhe konventa ndërkombëtare;



Numri i lëndës: 2019:0190727
Datë: 15.09.2023
Numri i dokumentit: 02683106

- b. koha kur është kryer vepra penale nga ana e të pandehurit ka qenë konflikt i armatosur, i pandehuri në bashkëkryerje edhe me dy pjesëtarë tjerë të sigurimit shtetëror serb, ka vepruar në mënyrë të përshkruar si në përshkrimin faktik të kësaj akuze;
- c. motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi nacional, sepse i dëmtuari është rrëmbyer vetëm se ka qenë i përkatësisë kombëtare shqiptare, e për më tepër ka qenë civil, i pa armatosur dhe rrjedhimisht edhe i pambrojtur;

PËRFUNDIMI;

Pas përfundimit të hetimeve dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës, prokurori i çështjes erdhi në përfundimin se në veprimet e të pandehurit Slavisha Filic, formohen të gjitha elementet e veprës penale krime lufte kundër popullsisë civile, nga neni 142 të KP të RSFJ-së.

Andaj, për arsyet e cekura më lartë propozojmë që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

PROKURORI SPECIAL
Atdhe Dema